



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/15  
Datë: 22.07.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për themelimin e Ekipit Nacional për hartimin e Strategjisë për Specializim të Mençur  
(Smart Specialisation)**

1. Ekipi Nacional për hartimin e Strategjisë për Specializim të Mençur përbëhet nga:
  - 1.1. Vedat Sagonjeva, Drejtor i Zyrës për Planifikim Strategjik, ZKM, kryesues;
  - 1.2. Agim Kukaj, Departamenti i Postë Telekomunikacionit dhe TIK, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit - zëvendës kryesues;
  - 1.3. Jeton Karaqica, Departamenti për Ekonomi dhe Tregti, ZKM - anëtar;
  - 1.4. Qamile Sinanaj, Departamenti për Arsimit të Lartë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës - anëtare;
  - 1.5. Valbona Dushi, Departamenti për Industri, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - anëtare;
  - 1.6. Sytrime Dervisholli, Departamenti për Tregti, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - anëtare;
  - 1.7. Laura Zherka, Departamenti për Inovacion, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit - anëtare;
  - 1.8. Qëndresa Shala, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) - anëtare;
  - 1.9. Fetah Podvorica, Akademia e Shkencës dhe Arteve të Kosovës - anëtar;
  - 1.10. Faton Berisha, Universiteti i Prishtinës, anëtar;
  - 1.11. Edmond Hajrizi, Universiteti për Biznes dhe Teknologji (UBT) - anëtar;
  - 1.12. Berat Rukiqi, Oda Ekonomike e Kosovës, anëtar;
  - 1.13. Dominik Deda, Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK) - anëtar;
  - 1.14. Uranik Begu, Qendra e Kosovës për Inovacion (ICK) - anëtar;
  - 1.15. Astrit Rexhaj, Klasteri i Industrisë së Metalit, Energjisë së Ripërtërishme dhe Inovacionit të Kosovës - anëtar.
2. Ekipi Nacional është përgjegjës për hartimin e Strategjisë për Specializim të Mençur, në përputhje me udhëzimet e Joint Research Centre të Komisionit Evropian.
3. Kryesuesi i Ekipit, sipas nevojës, për të mbështetur punën e Ekipit, fton si anëtarë ekspertë nga institucionet publike, akademike dhe shoqëria civile si dhe ekspertë të tjerë që kanë kompetencë profesionale për temat përkatëse.

4. Kryesuesi i Ekipit, mund të propozojë themelimin dhe përbërjen e grupeve tematike për fusha të caktuara të Strategjisë.
5. Zyra për Planifikim Strategjik, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, e kryeson dhe mbështetë punën e Ekipit Nacional dhe grupeve tematike përgjatë tërë procesit, në mbledhjen e të dhënave, përgatitjen e analizave dhe përgatitjen e dokumenteve të nevojshme, sipas nevojës.
6. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
7. Me këtë vendim shfuqizohet Vendimi Nr. 02/60, i datës 07.08.2018.
8. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë